



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:037120  
Datë: 08.08.2023  
Numri i dokumentit: 04563769

**C-IV.-13-1880**

*Ankuesja:*

**K E e K** Prishtinë,  
përfaqësuar nga Av S B, Prishtinë.

*Kundër*

*E paditura:*

**N.SH “XIM Strezovc”**, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**,  
lagja Lakrishtë rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me dt. 08 gusht 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankueses K E e K dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI066-0249 i datës 23 gusht 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Ankuesja e ka pagua taksen gjyqësore dhe nuk ngarkohet me shpenzime shtesë.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 26 shtator 2013, ankuesja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, kërkesë për rishikimin e Vendimit nr. GJI066-0249 i datës 23 gusht 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me të cilin ka kërkuar kompensimin për fatura të pa paguara për furnizim me rrymë nga N.SH “XIM Strezovc” (në likuidim), në shumë të përgjithshme prej 36,988.04€. Ankuesja pohoi se AL e ka marr vendimin pa e vërtetuar mirë gjendjen faktike dhe duke e zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe se ka parashtruar ankesë brenda afatit të përcaktuar nga AKP-ja, duke i ofruar të gjitha informacionet e kërkuara. Ka shtuar se kreditori nuk mund të pësoj dëm

për shkak se paditura nuk i ka respektuara procedurat ligjore që ndërmarrjen e privatizuar ta likuidoj menjëherë dhe se paditura nuk ka të drejtë që të deklarohen në lidhje me parashkrimin e kërkesës edhe kur ajo ekziston. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar: Kopjen e vendimit të atakuar, transaksionet e konsumatorit DGL-900509.

Me 08 prill 2014, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se në bazë të dispozitave ligjore duhej të ishte paraqitur kërkesë para gjykatës apo ndonjë autoritetit tjetër kompetent brenda tri viteve nga momenti kur NSH pretendohet të mos ketë kryer kundrejt parashtruesit obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia tregtare, e që është tri vite kur parashtruesit nuk i është kryer pagesa e faturave.

Me 25 shtator 2014, ankuesja paraqiti përgjigje ndaj mbrojtjes së të paditurës. E njëjta ka mbrojtur qëndrimin se e paditura nuk ka autorizime ligjore të involvohet si palë në procedurë dhe të refuzoj kërkesën me arsyetimin se borxhi është parashkruar, pasi që është organ i vendosjes.

Me 07 nëntor 2014 e paditura ka ushtruar kundërpërgjigje duke theksuar se kërkesa e parashtruesit është parashkruar, meqë ankuesja nuk ka parashtruar kërkesë në gjykatë edhe pese ka pasur mundësi që ta bëj atë për ta ndalur parashkrimin. E paditura është thirrur edhe në qëndrimin e Dhomës së Posaçme dhe ka bashkangjitur vendimin SCL-11-0050 te dt. 13 mars 2013. I ka propozuar Gjykatës refuzimin e ankesës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në pajtim me nenit 2 par.4 dhe 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore, dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Gjykata konstaton se vendimi i të paditurës është i drejtë sa i përket aplikimit të dispozitave të LMD-së, përkatësisht të nenit 374 ku thotë :

- *Kërkesat reciproke të personave shoqëror juridikë nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet.*
- *Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo livrim malli, punë ose shërbim të kryer.*

Në këtë aspekt ligji është i qartë sa i përket përshkrimit të kërkesës nëse ato nuk kërkohen brenda tre (3) viteve.

Komisioni shqyrtues i likuidimit ka vendosur drejtë kur ka konstatuar se kërkesa për pagimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për periudhën për periudhën 30.11.2001 -09.11.2002, në shumë prej 49.28 €, për periudhën 30.11.2001-03.11.2004, në shumë prej 12,850.54 €, për periudhën 14.11.2002-03.03.2003, në shumë prej 12.54 €, për periudhën 23.10.2002-28.01.2008, në shumë prej 10,932.18 €, për periudhën 20.04.2005-20.01.2008, në shumë prej 13,143.50 €, është parashkruar. Kjo për faktin se sipas gjykatës ankuesja kërkesën e saj për pagimin e borxhit për periudhën e lartcekur për herë të para e kishte paraqitur me 24 mars 2011 tek Komisioni i Likuidimit, ku tani borxhi ishte parashkruar sipas LMD-së.

Në këtë aspekt konform nenit 360 të LMD-se me parashkrimin pushon e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit.

Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar të borxhit për shkak të faturave të papaguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 vite, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 prej vite, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me faturat e papaguara të energjisë elektrike dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit.

Kundërshtimi i ankueses se Komisioni Shqyrtues i Likuidimit nuk është dashur të thirret në parashkrimin e kërkesës, sipas gjykatës është i pabazuar.

Kjo për faktin se Ligji Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përkatësisht nenit 6 parasheh:

*“Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën...”*

Neni 9 paragrafi .3 i të njëjti ligj parasheh:

*“Secili autoritet i likuidimit është pjesë integrale e Agjencisë. Të gjitha veprimet apo mosveprimet e autoritetit të likuidimit janë veprime dhe mosveprime të Agjencisë. Secili person*

*që punon, apo është i angazhuar apo i emëruar të ndihmojë autoritetin e likuidimit është „person i punësuar apo angazhuar nga Agjencia...”.*

Edhe neni 31. a) i Rregullores së Unmikut 2005/48 i cili ishte i zbatueshëm në kohën e shqyrtimit të kërkesë së ankueses parashikonte:

*“kërkesat që bien jashtë afatit të parashkrimit sipas ligjit në fuqi ose ato të cilat nuk janë bërë si duhet në gjykatën kompetente, përfshirë aty ku është e nevojshme edhe në gjykatë brenda afatit të parashkrimit, nuk do të kenë të drejtë të marrin pjesë dhe të përfitojnë...”*

Të njëjtën zgjidhje e parasheh edhe neni 36.2.1 i shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili është në fuqi.

Pra Agjencia Kosovare e Privatizimit konform dispozitave të më sipërme është themeluar për të administruar me NSH-të, ti ruaj dhe rris vlerën e NSH-ve dhe Komisioni i Likuidimit është pjesë integrale e Agjencisë dhe se çdo veprim apo mosveprim i këtij komisioni është veprim apo mosveprim i Agjencisë.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore për ankesë dhe nuk ngarkohet me shpenziem shtesë.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r i  
Shkelzen Sylaj